

MUZAFER XHAXHIU

BIBLIOTEKA

854-1

Xh40

vargje për  
dashurinë

814-1  
2440

MUZAFER XHAXHIU

LIBRARY  
32-915

VARGJE 14242

PËR DASHURINË

N. SH. BOTIMEVE «NAIM FRASHËRI»  
TIRANË, 1963

## A T D H E U

### NUK ËSHTË VALLË KJO POEZI?

Rri e mendoj herë herë me mërzi,  
Ç'ësht poezia sot kur me raketë  
Njeriu e la pas çdo fantazi,  
E kur në vargje yjt duken të zbetë!

E puthi emblema hënien romantike  
Dhe yjet një nga një do t'i trazojë...  
Po a nuk është vall' kjo poetikë,  
Që e frymëzon poetin të këndoje!

## NË DITËLINDJEN E PARTISË

Ne,

që dje zvarriseshim si hije  
dhe s'kishim moshë,

ne,

një miljon pikpyetje  
në një shoshë,

(se shoshë ish bërë Shqipëria)  
me mijra mijra vrîma,  
me dete,

male,

ajër plot,

dhe ne na zihej fryma,  
ne sot drejt majave marshojmë,

mëngjezeve të artë  
këpusim trëndafilat  
lart

në shtigjet partizane

dhe i mbjellim në kopshtije...

Ne

dje zvarriseshim si hije  
dhe s'kishim moshë,  
se moshë hijet s'kanë,

lindnim të mplakur,  
të lodhur që në drekë,  
nga horizonti i përgjakur  
i hidhnik sytë  
dhe pritnim shumë,  
                  oh, sa shumë!  
mbrëmjen,  
se dhëmbjet do t'i yshtnim  
me gjumë...

Tani  
s'ka pleq në vëndin tim,  
të gjithë: njëzetvjeçarë!

Ne lindëm  
kur shkundte stuhia,  
njëzet vjet më parë  
kur lindi

Partia!

Parti!

atdheun tonë e veshe  
(me bruc dje, me qeleshe)  
me kominoshet e puntorit.

Ti nënë njëzetvjeçare,  
e urtë si koha,  
të falen bijt njëzetvjeçarë!

Parakalojmë ne  
në ditëlindjen tënde,  
mbi shpatulla  
planet mbajmë

— viganët pesëvjeçarë —

Kur ngecim  
në hap të ecim  
na mëson,  
se rruga s'ësht e shtruar  
në asfalt...

Né,  
kryet lart,  
marshojmë...  
marshojmë...  
në hap me ritmet socialiste,  
se kemi ty në ballë  
Partia leniniste!

## ATE DITË NËNDORI...

Mbi supe ju mbanit  
tufanet e maleve,  
vërshimet e prrenjve  
plot zhurmë...

Dashuri e urejtje  
ju sillnit me vete,  
aromën e luleve,  
që kurrë s'i than  
cingërima,  
të shkrepave erën e ashpër,  
kur shkrep vetëtima...

Ju zbritët  
tabore-tabore  
me shpresë dëshira  
në Vlorë...

Një ditë me shi,  
me furtunë,

flamurin,  
rrahur në djell e stuhi  
çpalosët  
Nga Vjosa në Bunë...  
Atë ditë nëndori

gjëmuan fushat dhe malet,  
krokëllitën në varre,  
mbuluar pesë shekuj me radhë,  
eshtrat shqiptare...

U derdh anembanë  
urrejtja stuhi...

U tund Shqipëria...  
Nga vargu i shekujve  
thellë

shkëlqeu liria..

Vlorë...

që puthe me dallgët e detit  
si një vashë,

që për të parën herë  
të dashurit i hap krahërorë.

Vlorë...

që rrëmben rrufetë  
nga Malet e Vetëtimës  
e i shuan në det  
si plagët — zjarr me ujë,

ti Vlorë e ëmbël e ullishteve,  
e sarta Vlorë strall,

rrahur në zjarr,  
jatak për lebër,  
myzeqarë....

ti zonjë e madhe Vlorë

të ka hije  
ballët t'i zbulu kurosh

me kurorën që të dha  
historia...

Atë ditë nëndori  
nga Vlora nisi udhën  
Shqipëria  
mbi gërmadhat që i la robëria.

Krenare hodhi këmbët  
duke mbajtur mbi shpatulla  
plagë  
e shpresat në sy  
— të përgjakura —  
Tërbimin e furtunave çau,  
që iu rreshën mbi kokë,  
udhëkryqe...  
humnera...

kallkan e thëllimit,  
gjer çeli pranvera  
Nëndorit të madh  
të çlirimit...

## PARAKALON 1 MAI

Sheboja kundërmon  
e bari i njomë  
kryet lëshon përpjetë  
    i asdisur...  
e një afsh plot aromë  
i ngroht,  
    i ëmbël  
nga toka e rime avullon...  
Tirana ësht stolisur...  
(Si nuse ësht stolisur kjo Tiranë!)  
Në sheshe,  
    nëpër rrugë,  
                anembanë  
flamujt  
si një buqetë lulëkuqesh  
me gjuhëza prej flake  
me qiellin ligjërojnë.  
Rrugët gjëmojnë...  
harë,  
    gëzim,  
parakalon 1 Mai  
i veshur në blerim...

Parakalojnë  
planet pesë-vjeçarë.  
E tërë Shqipëria  
parakalon  
me flamujt fitimtarë  
në rrugën që çeli  
Partia!

Pranverë!  
Parakalon 1 Mai  
punëtor,  
veshur me kominoshe...  
shtrëngohen muskujt  
si një shuk çeliku!  
Me zëmër të çiltër shqiptare  
parakalon 1 Mai!

Armiku  
hunguron për rreth kufijve  
e pret...  
Po grushti e dërmon  
këdo që nget pranverën  
Main tonë!

## FLË BABI... ËNDËRON...

### — Balladë —

U vra si trim edhe ai,  
Tek ra në pushkë me dushman.  
Kur hyri djali në shtëpi  
E njohu babin partizan...

— Mami, ç'ka babi që s'po flet!  
— Shëët, se ësht lodhur e po flë...  
Dëgjon fashisti e na vret,  
Futu aty e mos bëj zë!

— Babi në ball ka një pik' gjak!  
— Ësht yll i kuq, o bir i nënës,  
Qëndisur anës me varak,  
Pa ësht i zbetë si drit' e hënës!

— Po ata burra që po vinë,  
Ç'e kanë në duar një flamur?  
Po atje poshtë në lëndinë  
Përse po hapet një qivur?

— O bir i nënës, ti s'e di  
Ç'ëndër të bukur po shikon  
Në këtë çast yt at për ty...  
Shëët! se po flë e na e zgjon!

## NGA NJË MËNGJES NË TJETRIN

Atë mëngjes, kur burrin larg e nisi,  
U ul dhe qau heshtur në lëndinë.  
Po atë verë luftë e madhe krisi,  
E gjaku i trimit ra mbi trendelinë.

Tani pas kaqë vjetësh ajo nis  
Për në Tiranë të birin një mëngjes:  
«Të fala nga yt at m'i bëj Partisë,  
Ai ta hapi rrugën për Kongres!»

## TË QETË FLENË PËLLUMBAT...

Ka zbritur mbi Tiranën nat' e qetë,  
Heshti çdo gjë... veç hëna udhëton.  
E nga dritare e hapur fllad i lehtë  
Vjen mbi trýezë e letrat m'i trazon.

Tek po kaloja nga një fletë te tjetra,  
Kur shoh kalin e drunjë pranë derës,  
Leleja e stisur më ca copa letra  
Lëkundet lehtë e lehtë nga flladi i erës...

Dhe rri mendoj e zëmra ndizet zjarr:  
Flë kali... flë kalorsi, i kapitur;  
Të qetë flën' nën qjellin shqipëtar  
Dhe ëndërojn' — kalorsit tanë të mitur.

Ata nuk dinë se kanë ende në botë  
Vëllezër që jetojnë sa një flutur,  
Njomza të gjelbra, që uri dhe sqotë  
Nga deg' e tyre shkojn' për t'i këputur.

Të qetë sonte flën' pëllumbat tanë,  
Dhe nanurisen ëmbël nga mendimet  
E prindërve që kujdes tjetër s'kanë  
Vec t'ua bëjnë të lehtë fluturimet...

## ÇAST PARTIZAN

Rreth zjarrit partizan u ndez një valle;  
Ç'e heqin trimat lehtë mbi lëndinë,  
Kërcejnë partizankat si sorkadhe,  
E ngrihen malesh hymne për lirinë.

Një partizan qëndroka i veçuar...  
Pushkën lëmon mbi gjunjë lehtë e lehtë...  
Ç'ka partizani që po rri menduar?  
Mos vallë iu ndez në zëmër mall i fshehtë?

Ka parë e ka dëgjuar këngë e valle,  
Po kaq të ëmbla s'i jan' dukur kurrë...  
Dhe hëna sonte i duket më e madhe,  
Sikur dhe veten sot e ndjen më burrë!

Nxjerr letrën prapë e qesh, tek rri mendon  
Se u bë atë... e i vjen turp, s'tregon!

## UJRAT E PRANVERËS

### — Fragmentë nga poemë —

Pranvere...

Qielli i murmë-mavi

me re të bardha ësht mbuluar,

Ka rënë shi...

Ndonjë yll i grisi retë

e rokopujë

ra mbi thërrime pasqyrash

të pellgjeve me ujë...

Mërziten yjet lart gjithnjë

e zgresin herë-herë...

Ka rënë shi...

Asfalti sterrë i rrugëve

lahet në neon...

Pranvera me zili

çveshi velin e hollë prej petalesh

e lakuriq

u la në shi.

E shiu e puthi pranverën

tër' atë natë,

e në mëngjes

i lodhur ra e fjeti...

Ajo

— pranvera —

u zgjua më e bukur,  
më e bukur,  
me buzë të ndezura rubin,  
të kaltërt syt si deti...  
Sa na pëlqen  
me pranvera moshën ta numurojmë,  
gëzohemi kur vjen,  
e kurrë s'kujtohem  
se ajo vdes,  
rilind,  
e ne mplakemi... shkojmë...

32.915

14242

2.

U err...  
Dritaren hap  
dhe shoh qytetin.  
Në një shtëpi përballë,  
përmes dritës së zbetë,  
në një kornizë dritareje  
çquaj një siluetë...  
Një vajzë  
plot temperament  
godet tastet e pjanos  
e si një flutur  
e lehtë  
(lule më lule)  
rëshqet  
me murmurimin e ujrave të pranverës  
në këngën e trishtuar të Solveit...  
Si cicërimë e zogut të plagosur  
që fluturon në kraht e erës,  
humbet kjo elegji,  
tani,

që valset plot gëzim  
mbytin çdo mërzi...  
Një tufë mjellmesh  
zbardhin n'errësirë.  
Posi një det  
i shkundur nga shtërgata  
buçet «Apasionata»...  
Ç'tinguj,  
ç'aroma  
përhapen nga duart e njoma  
të vashës,  
që shkasin mbi tastjerë!  
Pranverë!  
Kështu ësht gjithnjë  
në vendin tim,  
s'ka dimër asnijëherë!  
E përgëzojnë pjanisten  
me buzëqeshje metalike  
Grigu,  
Çajkovski,  
Beethoveni ,  
që mbi tastjerë  
parakalojnë të qetë  
si perënditë antike...  
Vajz' e bariut  
nga Labëria  
tani vallzon me orët e Ponkielit!  
Vjollcën,  
që çeli mbi shkrepë  
në një grusht dhë,  
në një buqetë lulesh,  
në tytë të pushkës  
e solli pranvera partizane...  
E Vjollca u bë pjanist!

Të rronte gjermani i madh  
Beethoven  
e të shihte sot:  
Në Gjermaninë revanshiste  
vringëllojnë armët,  
e ne ngrëmë  
të dhjetën simfoni:  
Pranverën socialiste!

3.

Qyteti flë...  
Në këtë orë të qetë  
e tres shikimin larg...  
Dridhen të zbetë  
lart në qiell yjet...  
si buzët e vajzës  
kur provon  
të puthurën e parë...  
Kërkoj me sy Saturnin,  
më ngjan sikur në rrëthim  
që i rri si aureolë,  
ka shtënë Venerën,  
e këcen me sy-mëshqerrën  
rokendrol...  
Fantazi yjesh  
mbi kaltërsi të errët qiejsh!  
Mbase atje lart  
nuk dinë rokendrol  
e hulahup!  
Mbase s'ka dete që trazohen  
atje lart,  
e s'ka detarë  
që hypin mbi katart  
e shohin mes dylbisë  
mos ndonjë pirat nga fisi janki

sulet t'i grabisë...  
.....

E hedh vështrimin larg...  
Sonte të bredh dua tër' botën!  
Më erdhën në prak  
një tufë mjellmesh plot frysëzim,  
që fluturuan nga gishtérinjt e Vjollcës  
deri vonë në agim...

4.

Mes avujve të muzgut  
nxijnë larg  
*piramidet e murme mijëvjeçare,*  
*djersë e balsamosur*  
**në ftohtësinë e shekujve barbarë.**  
Nga qelli mavi  
dielli  
si një pare e skuqur në zjarr,  
ulet pas palmave  
dhe shuhet në ujin e njelmë të detit...  
Më ngjan sikur në dorë e mbaj Afrikën!  
Po Afrika ësht e madhe  
sa lakkia,  
e rëndë  
si historia e thinjur  
që hiqet xvarrë  
mbi kurrizin e popujve afrikanë...  
Po shuhen hijet anembanë  
e bota kridhet n'errësirë...  
Keopsi vigan  
— mbreti «i mirë» —  
rrëndon mbi mijra varre sklavërish  
që përmendore i ngritën  
sklavërisë,  
e nxin Keopsi pisë...

Natë...

natë afrikane,  
me yj tē ndezur zjarr...  
ja ēsht banania shumē e lartē,  
ja nga qielli ka zbritur  
Arushe e madhe  
e ha banane mjaltē!  
(Kaq afér duken yjet!)

Natë...

heshti çdo gjë,  
zhungla... korrijet...

Sahara,

si u poq tērē ditēn nē zjarr,  
si kuçedër që s'ngihet,  
me gojēn plot rērē turfulloï  
pastaj ra e fjeti.

Dhe Nili mē ngadalë rjedh tanī,  
e me përtim rrugēn merr nga deti...

Tē shtratit anë rreh:

me një tē mbytur shushurimë  
e me ëmbëlsi  
ëndrat përkund afrikane...

Natë...

Flë nënë palma

Afrika...

Mbuluar me kunupjerë,  
nē një hamak  
«mejd in Amèrika»  
flë një guak miljoner.

Plot ankth flë,  
sikur e çpojnë thika...

nesér do tē mbledhë valixhet  
pér tē mos e parë më

Afrikën...

---

# ROMANCE DASHURIJE

## VEÇ NJË RUDHË . . .

Nuk them ta zbukuroi rudha ballin,  
Si brazdë e lehtë çarë me kujdes,  
Por ai ballë veç ma ndezi mallin,  
Si ndez agimi lulet në mëngjes!

Një rudhë . . . një thinjë . . . vallë e ngrysëm jetën?  
Kush tha se ne u implakëm në agim?  
Dëshirat . . . éndrat . . . gazin . . . të vërtetë  
Mbi ballin tonë gdhënd sot brezi im . . .

## MË THUAJ TI...

Kush i këndoi dashurisë  
E nuk iu duk se flet çapras!  
A duket fund i thellësisë  
Kur deti shkundet në tallas?

Sa zë të them se sa të dua  
Tufani zëmrën ma përplas...  
A mund të duket, as më thua,  
Fundi i detit në tallas?

## AS ZJARR AS YJE...

Të flas për dashurinë gjë s'më mbeti,  
Asaj me mijra vjet i kanë kënduar...  
Në pyje hënë e yje ka kërkuar  
Stoli për vashën gjithënë poeti.

Po syt e tu, besò, veç ata sy  
As janë zjarr as yje e s'kanë emër...  
S'harboj në qiej, veç kërkoj në zemër  
Të gjej vetëm një fjalëz për stoli...

## KËRKOVA NËPËR BOTË

Të kërkova vjeshtës me stuhi,  
Në pranverë kur çelin margeritat...  
Një mëngjes kur qielli fiku dritat  
I trishtuar ktheva në shtëpi...

Isha zhytur rëndë në mendime  
Kur m'u çfaqe yll në të aguar...  
Oh, sa shumë në botë të kam kërkuar  
E të gjeta thellë në zëmrën time!...

## NJË ÇAST...

Sa shpejt, e dashur, koha po kalon,  
Më duken muajt vetëm sa një ditë,  
E djelli ngjan sa lind zë perëndon  
Kur të përkëdhel lehtë flokët, gjitë.

Po çka pse koha rjedh kaq e nxituar,  
E n'udhë të jetës ecim ne pa kthim!  
Vetëm një çast me ty nuk ka të çmuar,  
Pqr ah, ky çast të zgjatej n'amëshim!

## KUR ECNIM BUZË DETIT

A të kujtohen mbrëmjet në bregdet,  
Kur ne mbi rërë ecnim dalngadalë,  
E filladi i pëshpëriste mijra fjalë  
Valës që shtrohej anës lehtë e lehtë?

Ti më shikoje ëmbël me ata sy  
Që flisnin me trishtim për dashurinë...  
E n'ato çaste njohëm lumturinë,  
Që përgjithmonë na lidhi ne të dy...

## PRES MBRËMJEN...

Të shoh gjithnjë në ëndër, shpirti im,  
Të puth, të përqafoj, të mbaj në gji,  
Të shtrëngoj fort e fort me adhurim,  
Se s'njoha kurrë të tillë dashuri...

Po ëndra bashk' me natën aratiset,  
E mu në zëmër hap një hon të thellë,  
Dhe unë pres... e pres...gjersa të ngryset,  
Të çfaqesh prapë me natën e mbështjellë...

## ATË MËNGJES...

Dy lot si dy inxhi t'u rukullisën  
Mbi faqezat e zbeta atë ditë,  
E më të bukur kurrë s't'i pash' sytë  
Se atë çast kur lotët t'i stolisën...

Ti më përcolle larg si tjetër herë...  
Një gaz i lehtë e lot i ndezur shpuzë  
Të dridheshin sëbashku nëpër buzë,  
Si djelli lot me shiun në pranverë...

## I FUNDIT LIMAN

Je shpirti im, je dritë,jeta vetë,  
Je ëndra më e bukur që kam parë,  
Liman i fundit je, ku zëmr' e vrarë  
Me gaz e hodhi hekurin për jetë...

Në dete shumë ania ime brodhi,  
Me valët lozonjare u përkund...  
Por n'ashnjë vënd s'qëndroi, gjersa në fund  
Limanin më të kaltërt ajo zgjodhi...

## MË NGJAN MË E BUKUR PA STOLI

Sa më pëlqen me flokët e lëshuar,  
Kur sytë t'i puth agimi sa ësht dukur,  
Sa më pëlqen fustani i vjetruar,  
Që trup'n e hijshëm ta skalit aq bukur!

Ti drrasat lan... e këmb' e zbathur tënde  
Me ujët përkëdhelet... c'lumturi!  
Oh, këmb' e derdhur në fildish, më çmënde!  
Ti uj' i lumatur sa të kam zili...

## DHE QESHËM... QESHËM...

Shkëlqente deti i kaltërt si pasqyrë,  
E flladi i lehtë frynte nëpër valë,  
Dhe un' e ti të ndezur në fytyrë  
Mbi rër'n e lagur ecnim dalngadalë...

Po në fytyrë prapë e ndjenim zjarrë,  
E sy më sy u pamë të hutuar!  
Dhe qeshëm... qeshëm... qeshëm si të marrë,  
Se rër' e lagur digje përvëluar!

## N È K A B I N È

Me sa gëzim vrapuam ne të dy  
Atë mëngjes të bukur në kabinë!  
Ti ishe ndezur zjarr, e n't'bukrat sy  
Sí në pasqyrë shikoja lumturinë...

Jasht' qetësi... aty-këtu një valë  
Përplasej përmbi bregun e shkretuar,  
Në qoshe të kabinës dalngadalë  
Një bisht cigari digjej... i harruar...

## S H P R E S E

Liqen! sa herë këtu në zall  
Kam dalë për të soditur...  
Me zëmrën mbushur plot me mall  
Diçka gjithnjë kam pritur...

Rrëshqasin valët një nga një  
Në rrugë pa kthim... ngadalë...  
Por un gjithmonë e pres atë  
Se nuk rrëshqet si valë...

## FËMIJT TË RINJT E PLEQT

Fëmijt e marrin puthjen pa kërkuar,  
Të rinjt nga buzët vajzës ia rrëmbejnë,  
Dhe pleqt rininë e zjarrt duke kujtuar  
Me çmim të lartë janë gati ta shpërblejnë...

Pse sot pa ta rrëmbyer ma dhuron  
Një puthje... dhe një tjetër... me mërzi?  
Mos vallë ti tani s'më dashuron?  
Pa çka!... pa çka!... veç puthimë si di til!

## LEGJENDE PËR DASHURINË

Do kalojn' vjete, shekuj do kalojnë...  
Kujtim i zbetë do mbesë nga ne të dy,  
Veç deti hëna yjet do tregojnë  
Sa shumë u dashuruam un e ti...

E në u shofshin yjet ndonjë ditë,  
E në shteroftë deti pambarim,  
Kjo dashuri e zjarrt gjithnjë do ndritë,  
Se ësht legjendë që rron në amëshim...

## P R A N V E R E

Ç'ia thot' çobani maleve,  
Ç'po bien zilet staneve,  
Zu' çeli lule-shqerra.  
Po rrjedh uji i burimeve  
Si akull i thëllimeve  
Lëndinave të blera.

Kumbon zëri i bilbilave  
Në gjijt e trëndafilave,  
Që çelin ndaj të għirrë.  
E vajzat ngjiten brigjeve,  
E djemt harbojnë shtigjeve,  
Nën qielin e dlirë.

E shkojnë i puthin fshehura  
Në flokët e pakrehura,  
Pa derdhen vrap zorkadhet...  
Po po! ç'u turpēruanë!  
Pa qeshin, se shpētuanë;  
S'u nganë portokallet!...

Po rrjedh uji i burimeve  
Si akull i thëllimeve  
Lëndinave të blera.  
Një pikë vajzat duan  
Të pinë... u përvëluan!  
E nxehthë paravera!

## S H E L G U

Hëna  
është lakuar  
si një hark i florinjt  
e shtie shigjeta  
në tokë...

Uji  
shushurit ëmbël  
e këndon nënë shelgun  
tek thyen shigjetat e arta...

E uji këndon  
e këndon...  
po shelgu  
vajton  
se shigjeta iu thye në zëmër...

## N D A R J E

Në thellësin' e syrit, ku rri fjetur  
Më shkrepëtin një sumbull lot i valë,  
Sa herë që mbrëmja zë e shtrydh ngadalë  
Të manushaqtat reze që kan' mbetur

Nga psherëtim' e muzgut përmbi mal...  
Dhe kur çdo gjë në gjin' e saj ka tretur  
E murmja natë, un endem për të gjetur  
Ndonjë kujtim të largët a një fjalë...

Një mbrëmje—e mbaj mënd mirë—kur më **erdhi**,  
**E** veshur si me natën yj-pikuar,  
Dhe buzët me nektar në shpirt m'i derdhi.

**E** pyeta pse aq shumë përvëluar  
I rrihte krahërori atë mbrëmje!  
Më tha se do të ndahej e ndjente dhëmbje...

## M'U NDEZ MALLI

Ç'ajo gojë si kuti,  
Skuq në degë kokra qershi!  
Ç'ata sy që s'kanë emër,  
Më pikojnë mu në zemër!

Ç'ajo hundë, e ç'ai ballë!  
Vashë, fort ma ndeze mallë!  
Ç'ai trup i lehtë flutur,  
Më këputë, mes-këputur!...

## MIMÖZAT E FUNDIT...

Mbi tufën e verdhë të mimozës  
ranë dy pika lot...  
Një bicikletë  
kaloi, aty afër  
dhe shkeli mimozën,  
që shkau nga dora é dridhur  
mbi asfaltin e lagur  
nga shiu...  
Ne u larguam...  
unë këndej...  
ajo andej...  
Kthyem kokën e pamë,  
e syt u kryqëzuan  
si në duel dy shpata...  
Mbi asfalt  
ishin derdhur ruaza mimozash  
e lotësh të hidhur...  
Asgjë nuk thamë,  
veç shkëmbyem  
mimozën  
dhe lotët  
atë ditë të murme shiu...

## DO TË KTHEHET...

Hëna e zbetë  
ka zbritur në dritare  
dhe më vështron me trishtim...  
Në kopshtin tim  
është asdisur mimoza.  
si gjoksi i vashës  
në pranverë...  
Dhe hëna  
e mbush mimozën me të puthura...  
se kushedi  
nesër mund t'i ikë  
si ajo që më iku...  
Mbrëmë  
hëna e pa  
tek puthej me një tjetër,  
në qoshen e errët,  
te një portë e vjetër...  
Hëna e pa dhe u droth...  
Në e pafsh përsëri  
mos u drith!  
Uroi lumturi  
dhe puthe!  
puthe!  
Ajo do të kthehet...  
se s'i pëlqen bunaca,  
dò stuhi...

# N A T Y R E

---

## V J E S H T È

Pushoi shtërgata...  
Natë e qetë...  
Filadi azhur të hollë  
qëndis përmbi kënetë...

Gjethe të thata  
po bien nga një mollë...

## P E R È N D I M . . .

Qielli i kaltërt  
puh më dëshirë  
buqët e detit të trëndafiltë,  
përkoj në horizont... .

Pastaj qidh o det  
treten në mugëtirë... .

## P A F U N D E S I

Disku i diellit,  
i skuqur në zjarr,  
u fundos në det  
po s'u shua...  
Mirjada  
u lëshuan  
në qiell  
thërmija,  
dhe spërkatën kupën e errët...

# PËRMBAJTJA

Faqe-

## A T D H E U

Nuk është vallë kjo poezi? .....	3
Në diëlindjen e Partisë .....	4
Atë ditë nëndori .....	7
Parakalon 1 Mai .....	10
Flë babi... Endéron...	12
Nga një mëngjes në tjetrin .....	13
Të qetë flenë pëllumbat .....	14
Çast partizan .....	15
Ujrat e pranverës — Fragmente nga poemë — .....	16

## R OMANCE DASHURIE

Veg një rughë... .....	22
Më thuaj ti... .....	23
As zjarr as yje... .....	24
Kérkova nëpër botë .....	25
Një çast... .....	26
Kur ecnim buzë detit .....	27
Pres mbrëmjen... .....	28
Atë mëngjes... .....	29
I fundit liman .....	30
Më ngjan më e bukur pa stoli .....	31
Dhe qeshëm... qeshëm... .....	32
Në kabinë .....	33
Shpresë .....	34
Fëmijt, të rinjt e pleqt .....	35
Legjendë për dashurinë .....	36
Pranverë .....	37
Shelgu .....	39
Ndarje .....	40
M'u ndez malli .....	41
Mimoza t e fundit .....	42
Do të kthehet... .....	43

## N AT Y R E

Vjeshtë .....	44
Perëndim .....	45
Pafundësi .....	46

32915

Redaktor: Razi Brahimë  
Korektor letrar: Ali Hashorva  
Piktore: Dolli Gjinali  
Redaktor teknik: Adem Lita

Tirazhi: 1500 kopje Format 70X100/32 Stash: 2204-55

Shtyp. N.I.Sh. Shtypshkronjave «MIHAL DURI» — Tiranë